



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Emiljeno / Predato Received / Delivered	15-06-2022	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinita Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shirja e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/HC/K	3544/2022		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.423/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.423/2022 të datës 26.04.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] të cilën me autorizim e përfaqëson avokati [redacted] me adresë, [redacted] Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.06.2022, mori këtë:

### V E N D I M

**PËRFUNDON** procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.423/2022 të datës 26.04.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

### A r s y e t i m

Ankuesja me datën 26.04.2022, përmes përfaqësuesit ligjor, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit Nr.prot.2406/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.538/2022 të datës 05.04.2022 i lëshuar nga Menaxheri i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme lidhur me sistemimin e ankueses në pozitën "Zyrtare e lartë e gjendjes civile " në Drejtoratin e Gjendjes Civile të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 29.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ministria e Punëve të Brendshme me datën 13.05.2022 përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Me datën 08.06.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër VK.nr.51/2022 sipas të cilit ankesës së ankueses i është vazhduar afati për vendim marrje edhe për dhjetë (10) ditë pune të tjera.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.prot:2406/2022 të datës 26.04.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 13.04.2022 nga përfaqësuesi ligjor i ankueses; Vendimin me numër A.nr.66/2022 të datës 14.03.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 19.12.2018 nga ankuesja për pezullim të dakorduar nga MPB-ja; Vendimin me numër Nr.prot.1026 të datës 28.12.2018 për pezullimin e statusit të nëpunësit civil; Ankesën e ankueses të datës 26.01.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.1488/2021 të datës 28.12.2021 të zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin me numër Nr.1504/2021 të datës 31.12.2021 lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankueses; Njoftimin e datës 19.04.2022 nga përfaqësuesi ligjor i ankueses për mos zbatimin e vendimit të Këshillit; E-mailin e datës 02.12.2022 nga ankuesja; E-mailin e datës 08.12.2021; E-mailin e datës 09.12.2021; Emailin zyrtar të datës 15.01.2022; Emailin zyrtar të datës 15.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 13.05.2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme me provat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e ankueses me numër Nr.ref: NJAB-03/13 të datës 18.11.2013; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër Nr.01-5420/18 të datës 10.12.2018 të ankueses; Vërtetimin me numër Nr.05-2966 të datës 27.10.2020 lidhur me përvojën e punës së ankueses në Telekomun e Kosovës; Përshkrimin e detyrave të punës së ankueses për pozitën Auditore të brendshme; E-mailin zyrtar të datës 10.12.2021 dhe E-mailin zyrtar të datës 13.12.2021. ;;; Procesverbalin me numër Nr.01-5053/18 të datës 22.11.2018; Autorizimin e datës 19.01.2022 nga avokati për ankuesen; Vendimin me numër Nr.01-5052/18 të datës 22.11/18 për përzgjedhjen e kandidatit; Përgjigjen në kërkesë të datës 17.01.2022 me numër 039; E-mailin zyrtar të datës 17.01.2022; Formularin e shpenzimit të departamentit, divizionit ose sektorit lidhur me planifikimin e buxhetit 2022 të datës 25.06.2021; Planin legjislativ për aktet nënligjore për vitin 2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme; Kërkesën për prova shtesë të datës 27.05.2022 dhe 10.06.2022 nga KPMSHCK-ja; Përgjigjen në kërkesë të datës 01.06.2022 dhe 14.06.2022 përmes e-mailit zyrtar nga MPB-ja së bashku me akt emërimet e nëpunësve civil për pozitën Auditor në MPB dhe Vendimin me numër VK.nr.51/2022 të datës 08.06.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses [redacted] është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar ankesën e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ndër të tjera kërkon që pas aprovimit të ankesës e njëjta të kthehet në pozitën e Auditorës së Brendshme pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka konstatuar se pas pranimit të vendimit të Këshillit A.nr.66/2022 të datës 14.03.2022, ndaj ankueses me datën 05.04.2022 Menaxheri i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.ref.538/2022 sipas të cilit ankuesja është sistemuar në pozitën "Zyrtare e lartë e gjendjes civile" në Sektorin e gjendjes civile në Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjë të cilën pozitë edhe ankuesja e ka pranuar. Ndërlidhur me këtë fakt, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 10.06.2022, ka kërkuar informata zyrtare nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme në lidhje me pozitat e lira të cilat i kanë për "Auditor te brendshëm" në këtë institucion dhe sipas përgjigjes se tyre dhënë për Këshillin me datën 14.06.2022, ky institucion ka deklaruar se sipas planifikimit buxhetor të vitit 2022 i kanë të planifikuara katër (4) pozita për Auditor të brendshëm, ku për momentin janë katër (4) nëpunës civil në pozitën e Auditorit te brendshëm dhe si dëshmi na i kanë ofruar akt emërimet e nëpunësve civil të cilët i mbajnë këto pozita.

Prandaj pas analizimit të fakteve dhe dëshmive në provat e lëndës dhe duke u bazuar në rrethanat si më lartë, vlerëson se objekti i ankesës me numër A.nr.423/2022 i datës 26.04.2022 është i njëjtë me objektin e ankesës së ankueses të datës 26.01.2022, për të cilin Këshilli kishte vendosur në mënyrë meritore me datën 14.03.2022 përmes Vendimit A.nr.66/2022, sepse bazohet në qëllimin dhe gjendjen faktike të njëjtë, nga se nëse shikohet petitumi i ankesës kërkohet që ankuesja të sistemohet në pozitë të auditores së brendshme apo pozitë ekuivalente nëse nuk ka pozitë të tillë, rrjedhimisht e njëjta/ankuesja në mungesë të një pozite të auditores brenda këtij institucioni është sistemuar në pozitë të kategorisë së njëjtë profesionale kështu që nisur nga ky konstatim dhe në kuptim të dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një organ publik përfundon një procedure administrative, në cilëndo fazë të saj , nëse zbulon se : gjate me pak se dy (2) viteve para datës se parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike..."*, kështu që Kolegji konstaton se duhet të vendoset lidhur me përfundimin e procedimit administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.423/2022 të datës 26.04.2022 të parashtruar nga ankuesja

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.423/2022, datë 15.06.2022.

Ardita Perçuku-Shyti

*Ardita Perçuku-Shyti*  
Zyrtare e larte për bashkëpunim profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- ❖ Përfaqësuesit të ankueses, [REDACTED]
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- ❖ Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

